



K.DH.SH.II.nr.1008/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Mili Company” Sh.P.K me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S... SH.A. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2834/18, të datës 29.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.11.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Mili Company” Sh.P.K me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2834/18, të datës 29.01.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Mili Company” Sh.P.K me seli në Prishtinë, dhe ka lënë në fuqi aktvendimin me nr.01.3.2.2/565, 622 datës 23.10 .2018 të Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe korrigjimi nr. nr. 565,622 datë 14.11.2018.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit si e bazuar dhe të anulohet aktgjykimi A.nr.2834/18, të datës 29.01.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative/ Divizioni Fiskal.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala e paditur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63.2 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.01.3.2.2/565, 622 datës 23.10 .2018 ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e vendimit DUD-ave nr.R-7701/24.08.2018 e korrigjuar sipas korrigjimit nr. 565/622 të datës 14.11.2018 ndërsa pika 2 e dispozitivit të aktvendimit të kundërshtuar e që i referohet pezullimit të procedurës për DUD nr. 7616/22.08.2018, nr. 9554/10.10.2018 dhe nr. 9299/03.10.2018 .

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ-Divizion Fiskal për këtë çështje ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor në prani të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur dhe vërtetimit të gjendjes faktike, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ndërsa e len në fuqi aktvendimin e organit të paditur me nr.01.3.2.2/565, 622 datës 23.10 .2018 të Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe korrigjimi nr. nr. 565,622 datë 14.11.2018 , sipas theksimeve si në arsyetim ndër të tjera se: “Gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për

import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, andaj Dogana ka vendosur që vlera doganore të caktohet në bazë të metodës së 6 (gjashtë) të vlerësimit në vështrim të nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave, respektivisht në bazë të të dhënave me të cilat disponon Dogana e Kosovës, që në rastin konkret janë marrë nga Sektori i Vlerës, vlerësim ky i cili është bërë duke i shfrytëzuar informatat e marra nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë. Dokumentacioni përcjellës i mallit është konsideruar i pamjaftueshëm pasi që mungon deklarata eksportuese dhe transferet bankare për të dëshmuar se për mallin lëndorë është kryer pagesa në emër të faturës, prandaj vlera e mallit e paraqitur nga paditësi nuk paraqet vlerën reale të mallit. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndorë është vlerë e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor se të gjitha dokumentet janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së transaksionit të kryer për mallin e blerë, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i kësaj gjykate, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar- aktvendimit të Doganës së Kosovës, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të atakuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi nuk ka dëshmuar me dokumentacion adekuat dhe bindës për tu dëshmuar vlera reale e paguar për mallin lëndor, dhe për tu bërë zhdoganimi sipas DUD-ave të lartcekur me metodën e parë (neni 33 të KDA), andaj me të drejtë nga Dogana e Kosovës i është kontestuar

vlera e deklaruar e mallit për zhdoganim, pasi që paditësi nuk ka mundur të argumentoj me prova konkrete mënyrën e pagesës për blerjen e mallit lëndor, dhe në këtë drejtim gjykata nuk ka mund të pranoj pretendimet në kërkesëpadinë e paditësit. Kolegji njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se Dogana e Kosovës, bazuar në faktet e cekura si më lartë me të drejtë ka aplikuar metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit, neni 35 i KDA-së, në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës për mallin e njëjtë, është bërë përcaktimi i çmimit real të zhdoganimit, e jo ai i deklaruar nga subjekti me çmim më të ulët, sipas dokumenteve përcjellëse të mallit.

Pretendimet ankimore të ankuesit se nuk janë analizuar dokumentet e bashkangjitura deklaratës doganore faturën dhe pagesën bankare e cila përputhet me vlerën e faturave përkatësisht të DUD-ave kontestues, kolegji i refuzon si të pa bazuara dhe jo me ndikim për vendosjen e çështjes në mënyrë tjetër, nga ajo që është vendosur në gjykatën e shkallës së parë, sepse Dhoma e Shkallës së Dytë njëjtë sikur edhe gjykata në shkallë të parë, në shkresat e lëndës të paraqitura nga paditësi ka gjetur se për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e vërtet të transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor gjithashtu nuk ka deklaruar transfer bankar në bazë të së cilit do të dëshmohej pagesa për mallrat lëndore, nga ana tjetër e paditura posedon informacione dhe të dhëna sic janë DUD-at referues si: R-13727/15.06.2017, R-2638/14.04.2018, R-14963/11.06.2018, R-4417/29.05.2018, R-1603/20.08.2018, R-1128/20.04.2018, R-8674/19.09.2018, R-1132/22.02.2018, R2701/14.04.2018, dhe e njëjta pagesë nuk është e harmonizuar me vlerën e faturave të mallrave lëndore ku me këtë nuk ka mundur të vërtetoj se është bërë pagesa për faturat e mallit doganor e që do të dëshmonte vlerën e transaksionit konform neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 dhe nga të cilat dokumente do të mund të konstatohet se paditësi ka paraqit dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar në bazë të neni 123 të UA 11/2009.

Dhoma e Shkallës së dytë vlerëson se gjendja faktike e çështjes gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur është vërtetuar në mënyrë të plotë. Kolegji po ashtu vlerëson se dëshmitë në të cilat thirret në ankesë paditësi, vërtetohet se nga gjykata e shkallës së parë janë shqyrtuar në tërësi, por nuk është arrit të dëshmohet se janë prova të qëndrueshme dhe bindëse materiale, për tu dëshmuar vlera reale e mallit, andaj për shkak të metave të tyre nuk janë

pranuar si të vlefshme, sepse nuk është dëshmuar vlera reale e mallit lëndor, sipas DUD-ave kontestues.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1008/22, me datë 06.11.2023

Kryetare e kolegjit,

Saranda Bogaj Sheremeti